

**EDMOND MALAJ**

**DISA ASPEKTE NGA PUSHTIMI I SHKODRËS  
DHE I QENDRAVE PËRRETH SAJ NGA OSMANËT  
NË FUNDIN E SHEKULLIT XV**

Në këtë artikull po përpiqem të paraqes disa aspekte të perëndimit të qytetërimit shqiptar mesjetar të shkaktuar nga pushtimi osman, duke u përqendruar vetëm në qytetin e Shkodrës dhe të disa qendrave përreth saj, siç ishin Drishti, Deja, dhe Lezha, qendra këto që gjendeshin vetëm disa kilometra larg qytetit të Shkodrës.

Pra gjeografikisht në këtë artikull do të përfshij krahinat duke u nisur nga grykëderdhja e Bunës, nga hynin edhe anijet për të mbërritur në Shkodrën mesjetare (në afërsi të grykëderdhjes ndodhej dikur manastiri benediktin *San Nicola de lu Drinu*), duke vazhduar pastaj përgjatë vijës së saj, nëpër Shirgj dhe Shas (Shasi ndodhet në afërsi të lumit Buna), duke mbërritur në Shkodër, afër së cilës ndodheshin edhe qytetet Bolec, Drisht dhe fshati Ostros me manastirin e famshëm të së “Paperlyerës së Krajës”, dikur arqipeshkvi katolike, duke zbritur pastaj përgjatë vijës së Drinit nëpër Dejë dhe Sardë, e pastaj duke vazhduar më tej në Lezhë, deri në Shën Gjini në portin e vjetër San Giovanni di Medua, ku derdhet edhe sot njëri krah i Drinit.\* Pra, midis këtyre ujërave formohet një gjysmërreth i mbushur me qytete dhe shumë fshatra mesjetare, manastire, kisha dhe objekte të tjera kulturi, të cilat pothuajse të gjitha nuk ekzistojnë më. Pjesa më e madhe e tyre e pësoi shkatërrimin kryesisht nga dyndjet e ushtrive osmane. Këto pushtime ndodhën në një kohë kur Venediku, të cilin osmanët e shqetësonin në zotërimet e tij lindore, madje edhe në vetë kufijtë e tij, ishte varfëruar nga lufta dhe me zor po qëndronte.<sup>1</sup>

Më tej do të jap edhe disa të dhëna mbi pushtimin e Ulqinit dhe të Tivarit, pasi këto qytete, edhe pse nuk bëjnë pjesë në zonën e përkufizuar

---

\* Duhet të theksoj se Drini ndahet në dy degë, njëra bashkohet me Bunën nën kodrën e Kështjellës Rozafat, kurse tjetra derdhet në Shëngjin.

<sup>1</sup> *Historia e Perandorisë Osmane*. Nën Drejtimin e Robert Mantran. Përktheu: Prof. Asti Papa, red. shkencor Dritan Egro, Tiranë: “Dituria”, 2004, f. 105. (Në vazhdim cituar si: R. Matran, *Historia e Perandorisë Osmane*, f.)

më sipër, prapëseprapë ato ishin në marrëdhënie të ngushta dhe të drejtpërdrejta ekonomike, politike, kishtare dhe kulturore me qendrat e sipërpërmendura, dhe nga ana tjetër nuk janë shumë larg dhe më vonë (në shek. XVI) u bënë pjesë të sanxhakut të Shkodrës. Të gjitha këto qendra ndodhen afër Shkodrës, në një distancë prej 10 apo 15 km në vijë të drejtë. Edhe Ulqini dhe Tivari që janë pak më të distancuar, duke u nisur nga Shkodra arrihen brenda një ore udhëtimi.

### **Rrethimi i parë i Shkodrës nga osmanët**

Në kohën e sulltan Mehmetit II Shkodra u rrethua më 1474 nga bejlerbegu i Rumelisë, Sulejman Pashë Eunuku<sup>2</sup>, por Antonio Loredano e mbrojti qytetin me mbi 2000 ushtarë.<sup>3</sup> Antonio Loredano pati ndihmën e flotës venedikase në Bunë dhe në det më në krye Triadan Grittin, i cili në atë kohë ishte 80 vjeçar.<sup>4</sup> Po ashtu pati mbështetjen e Cërnojeviqit të Malit të Zi dhe të shqiptarëve malësorë.<sup>5</sup> Leonardo Boldu, i cili ishte caktuar si proveditor për luftën i dërgonte nëpër rrugët malore

<sup>2</sup> *Sulejman Pasha ishte me origjinë nga Bosnja. Në moshë fëmijore ishte kapur rob dhe për shkak të bukurisë së tij të madhe fizike sulltani e kishte bërë eunuk.* Joseph von Hammer-Purgstall, *Geschichte des Osmanischen Reiches*. Band 2. Einleitung und Bibliographie Prof. Dr. Herbert W. Duda. Eilftes Buch. Graz: Akademischer Druck und Verlagsanstalt 1963, 2, f. 136. ref. d. (=Veröffentlichungen der Hammer-Purgstallgesellschaft. Hrsg. v. Franz Sauer. Reihe A. Joseph v. Hammer-Purgstall. Werke. Geschichte des Osmanischen Reiches. Band 1-10). (Cituar si: J. Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches* 2, f.).

<sup>3</sup> Gjergj Merula, “Lufta e Shkodrës 1474”, në: Marin Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*. Përkthyer prej origjinalit latinisht nga Henrik Lacaj. Botim i dytë i shtuar. Tiranë: Universiteti i Tiranës 1967, f. 115. (=Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë 1.) (Cituar si: Merula, “Lufta e Shkodrës 1474”, në: M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, f.).

<sup>4</sup> Po aty, 115.

<sup>5</sup> Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [e të tjerë]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 106. (Cituar si: K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen* I, f.)

Cërnojeviqit lëndë për ndërtimin e fusteve që do të përdreshin në luftë.<sup>6</sup> Në këtë vit u dërgua në Shkodër edhe Giorgio Gabeta, kapiten stratiotas.<sup>7</sup>

Anijet venedikase që morën pjesë në këtë luftë, pra kundër rrethimit të parë, duket se ishin 14 galera të lehta dhe të rënda, 8 fuste (anije të shpejta lufte) 12 anije të mëdha dhe rreth 100 barka.<sup>8</sup> Gjithashtu ishin dërguar nga Venediku më tepër se 1000 marinarë që me monoskila (barka të vogla të gdhendura nga një trung) ruanin liqenin dhe nuk i linin të qeta trupat osmane që ishin vendosur përgjatë lumit Buna.<sup>9</sup> Në të njëjtën kohë Cërnojeviqi u angazhua me një ushtri prej 8000 luftëtarësh, si dhe kishte vënë në dispozicion portin e Kotorrit për të ndërtuar anijet që do të shkonin në Shkodër.<sup>10</sup>

Osmanët i gjuajtën muret e kështjellës me topa që i kishin derdhur nën muret e saj dhe pas disa ditësh muret u thyen.<sup>11</sup> Sipas Hammer-Purgstall, osmanët mundën të hynin nëpërmjet të çarave të murit në kështjellë dhe sulmi midis sulmuesve dhe mbrojtësve zgjati më tepër se 8 orë.<sup>12</sup> Më në fund pushtuesit u tërhoqën duke lënë shtatë mijë të vdekur nëpër mure dhe gropa.<sup>13</sup> Të rrethuarit ankoreshin për mungesë ushqimi, dhe filluan të flitnin edhe për dorëzimin e kështjellës. Atëherë Loredano i mblodhi të pakënaqurit dhe u përshkroi atyre me ngjyra të gjalla skllavërimin nga ana e turqve, dhe zbuloi gjoksin e tij duke thënë: “*Të uriturit le të shqyejnë gjoksin tim, dhe të ushqehen me mishin tim!*”<sup>14</sup> Këto fjalë ndikuan tek dëgjuesit për mrekulli dhe të gjithë thirrën: “*Rroftë Venediku, më parë të vdesim, se sa të dorëzohemi!*”<sup>15</sup> Turqit qëndruan deri në mesin e gushtit para mureve të Shkodrës, pa guxuar të

<sup>6</sup> Lulëzim Lajçi, *Shkodra në shekullin e XV*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës 1997, f. 111 (Cituar si: L. Lajçi, *Shkodra në shekullin XV*, f.).

<sup>7</sup> Giuseppe (Zef) Valentini, *Kontribute në kronologjinë e historisë së Shqipërisë 1060-1560*. (Pa vend botimi): “Plejada”, 2010, f. 273. (= Plejada e Mendimit albanologjik. Seria “Valentini”) (Cituar si: Z. Valentini, *Kontribute 1060-1560*, f.).

<sup>8</sup> L. Lajçi, *Shkodra në shekullin XV*, f. 111.

<sup>9</sup> *Po aty*.

<sup>10</sup> *Po aty*, f. 112-113.

<sup>11</sup> J. Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches* 2, f. 136.

<sup>12</sup> *Po aty*.

<sup>13</sup> *Po aty*.

<sup>14</sup> *Po aty*.

<sup>15</sup> *Po aty*.

ripërsëritnin sulmin, ngaqë edhe Gritti i kishte thyer ata (flotën turke) në lumin Buna.<sup>16</sup>

Por gjatë kësaj kohe ishte i pranishëm edhe një armik tjetër për të dyja palët. Ky armik ishte malarja dhe sëmundje të tjera që vinin nga ujët e infektuar të moçaleve. (Duhet të shtoj këtu që zona përreth është e mbushur edhe sot me pellgje kënetore të cilat, janë burim mushkonjash). Përveç kësaj, grykëderdhja e Bunës, e pastaj duke lundruar më sipër në drejtim të Shkodrës, ka zona moçalore. Në Mesjetë njihej si zonë me ajër të keq dhe i dëmshëm për shëndetin.<sup>17</sup> Nga malarja u sëmurën qoftë nga pala e të rrethuarve në kështjellë, qoftë nga pala osmane.<sup>18</sup> Nga venedikasit, ndër të tjerë, vdiq Bembo, kurse Gritti, i sëmurë rëndë u dërgua për në Raguzë,<sup>19</sup> ku mesa duket vdiq, pasi vdekjen e tij dhe të Ludovik Bambos e përmend edhe Gjergj Merula aleksandrinasi në letrën e tij të 10 shtatorit 1474.<sup>20</sup>

Turqit që nuk mundën ta pushtonin qytetin u bënë gati të iknin, thyen topat që i kishin derdhur për këtë rrethim, e morën metalin me vete dhe u drejtuan në drejtim të Karabogdanit (në Moldavi) ku për shkak të lodhjes nga rrethimi i mëparshëm pësuan edhe atje një disfatë.<sup>21</sup> Kurse, një pjesë tjetër e kësaj ushtrie u drejtua nga veriperëndimi. Pesëmbëdhjetëmijë “*vrapues dhe djegës*” të cilët kishin luftuar nën muret e Shkodrës u drejtuan nën komandën e Mihalogli kundër Dalmacisë dhe Krainës dhe morën me vete, sipas Hammer-Purgstall, njëzetmijë të kapur rob.<sup>22</sup> Kjo ndodhi si hakmarrje pasi në mbrojtjen e Shkodrës kishin marrë pjesë edhe dy oficerë raguzanë, duke e detyruar qytetin e Raguzës që të paguante një tribut prej dhjetëmijë dukatësh.<sup>23</sup>

<sup>16</sup> *Po aty.*

<sup>17</sup> “*ob aeris intemperiem qui in dies insalubrior et periculosior fit*” Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*. München: Oldenburg 2001. (Südosteuropäische Arbeiten 110. Für Südost-Institut München Hrsg. v. Edgar Hösch und Karl Nehring.), f. 24. (Cituar si: O. Schmitt, *Das venezianische Albanien*, f.).

<sup>18</sup> L. Lajçi, *Shkodra në shekullin XV*, f. 120.

<sup>19</sup> *Po aty.*

<sup>20</sup> Gj. Merula, “Lufta e Shkodrës 1474”, në: M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, f. 123.

<sup>21</sup> L. Lajçi, *Shkodra në shekullin XV*, f. 121.

<sup>22</sup> J. Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches* 2, f. 136.

<sup>23</sup> *Po aty.*

Këta kishin qenë disa muaj më parë dhe në zonat e Kerntenit, Stajermarkut, (Austri jugore) ku kishin djegur, plaçkitur dhe vrarë.<sup>24</sup> Në dimrin e viteve 1473-1474 kishin bërë shumë djegie dhe plaçkitje edhe në Hungari duke djegur më 6 shkurt 1474, në ditën e Shën Doroteas Vaadinin, vendin ku ndodhej varri i Shën Vladislavit.<sup>25</sup> Aty ata kishin bërë kërdrinë nëpër banorë duke u prerë kokat pleqve dhe fëmijëve, dhe duke grabitur vajzat dhe djemtë adoleshentë.<sup>26</sup>

Bali Oghlu Malkovic, Begu i Semendras, i cili kishte qenë udhëheqësi i kësaj fushate të egër, dërgoi në Stamboll si trofe shumë thasë të mbushur me koka, veshë dhe hundë të prera.<sup>27</sup> Rezistencën e fortë dhe të guximshme, të cilën nuk e kishin hasur në Kroaci, Krain, Kernten, Shtajermark të Austrisë, në Slloveni dhe në Hungari, osmanët e gjetën në Shqipëri para mureve të Shkodrës.<sup>28</sup> Pas përfundimit të rrethimit, qytetarët e Shkodrës, të lodhur dhe të sfilatur nga rrethimi, të etur për ujë, por të gëzuar për shkak të tërheqjes së armikut u derdhën në breg të Bunës për të shuar etjen.<sup>29</sup> Disa prej tyre mbetën të vdekur, ngaqë kishin pirë shumë ujë, aq shumë sa më pas i kapi një dridhje vdekjeprurëse e gjymtyrëve, duke u sjellë atyre vdekjen.<sup>30</sup>

### **Pushtimi dhe shkatërrimi i Dejës**

Pushtuesit osmanë gjatë rrethimit të Shkodrës iu afruan edhe qytetit të Dejës (*Dagno*). Deja mesa duket ra në duar të turqve në vitin 1474 dhe për këtë ishte shkaktar Pjetër Salamori, i cili pastaj u dënua që kishte dorëzuar këtë qytet (sipas Zef Valentinit dokumenti që flet për këtë është i datës 21.6.1474).<sup>31</sup> Qyteti u shkatërrua nga forcat e Sulejman Pashës, i cili nuk kishte mundur të pushtonte Shkodrën në Rrethimin e Parë dhe ishte drejtuar në drejtim të Prizrenit. Osmanët shkatërruan aty Dejën edhe kishën e lartpërmendur të Zonjës në Dejë.<sup>32</sup> Nga ky shkatërrim Deja nuk

<sup>24</sup> *Po aty*, f. 135.

<sup>25</sup> *Po aty*.

<sup>26</sup> *Po aty*, f. 136.

<sup>27</sup> *Po aty*.

<sup>28</sup> *Po aty*.

<sup>29</sup> L. Lajçi, *Shkodra në shekullin XV*, f. 121.

<sup>30</sup> *Po aty*.

<sup>31</sup> Z. Valentini, *Kontribute 1060-1560*, f. 167.

<sup>32</sup> L. Lajçi, *Shkodra në shekullin XV*, f. 121.

u ripërtëri kurrë më. Përsa i përket Sardës, e cila si vendndodhje është fare pranë Dejës, ajo nuk banohej më në kohërat e dyndjeve turke.

### **Rrethimi i dytë i Shkodrës dhe pushtimi**

Megjithëse Rrethimi i Parë i Shkodrës dështoi, osmanët nuk e ndërprejnë luftën për pushtimin e këtij qyteti dhe të Krujës, si rrjedhim të të gjitha trojeve shqiptare. Ata erdhën përsëri me ushtri të mëdha, që i paraprinë ardhjes së vetë sulltan Mehmetit II. Osmanët vazhdonin të mbanin Krujën të rrethuar që nga viti 1477 dhe tani filluan t'i afroreshin edhe territoreve të Shkodrës. Ata dalloheshin prej së largu pikërisht nga tymi që nxirrnin fshatrat që digjeshin përreth, që u vihej flaka nga “vrapuesit dhe zjarrvënësit” e tyre të frikshëm, që ishin edhe pararoja e ushtrisë dhe që qenë të parët që filluan rrethimin e Shkodrës.<sup>33</sup> Ushtria osmane përbëhej nga këto trupa<sup>34</sup>:

- *Ali Mihalogli*, gjeneral i tetëmijë “vrapuesve dhe zjarrvënësve”;
- *Iskender, Sanxhakgebu i Bosnies*, vëlla i Ali Mihaloglusë me katërmij kalorës;
- *Malkoviq (Malakoxh Ogli)*, sanxhakbeu i Serbisë me tre mijë kalorës;
- *Ahmed Begu* i biri i Evrenozit, me *Omar begun* të ngarkuar me punë xheniere, për rregullim rrugësh, prishje apo ndërtim urash;
- *Daut Pasha*, bejlerbeg i Rumelisë me ushtri, që ishte vetë një shqiptar i lindur. Ai qe grabitur në moshë të njomë, ra në sy për talentin e tij ushtarak dhe më vonë për meritat e tij iu dhe grada e bejlerbegut të Rumelisë;
- Mustafa Begu, bejlerbeg i Anadollit me ushtri;
- Ushtri jeniçerësh që i paraprinë sulltan Mehmetit II, pastaj
- Sulltan Mehmeti II me një pjesë tjetër të ushtrisë që erdhi më vonë.

<sup>33</sup> “Vrapuesit dhe zjarrvënësit” (gjerm. *Renner und Brenner*). J. Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches* 2, f. 156.

<sup>34</sup> Në lidhje me përbërjen e ushtrisë osmane shih: Po aty, f. 154-159.



Fig. 1. Harta me skemën e Rrethimit II të Shkodrës: Vandel, Hoseflook, Miti. Marrë nga Marin Barleti, *The Siege of Shkodra. Albania's Courageous Stand against ottoman conquest, 1478*. Translated & edited by David Hoseflook. Tiranë: Onufri 2012, pa nr. faqeje

Duhet të theksohet këtu që për pushtimin e Shkodrës (Arnavud Iskëderie) dhe krahinave përreth saj, qe ngarkuar nga sulltani, Gjedik Ahmed Pasha, i cili qe vetë me origjinë shkodrane, por ky kërkoi që të lirohej nga kjo fushatë dhe dha dorëheqjen. Për këtë veprim u burgos në kështjellën e Bogar Qesenit në Stamboll.<sup>35</sup> Për t'i bërë ballë rrethimit venecianët morën masa të ndryshme si në furnizimin e qytetit me ushqime, para dhe materiale të tjera, si në mobilizimin e forcave ushtarake të tjera, siç ishte për shembull mobilizimi i kontingjenteve të galerave të qyteteve dhe ishujve dalmatin, nga të cilat katër prej tyre për mbrojtjen e Shqipërisë.<sup>36</sup>

Rrethimin e Dytë, të bërë në vitin 1478, pra siç e pamë edhe nga renditja e mësipërme e pjesëmarrësve aty, e ka drejtuar personalisht Mehmeti II.<sup>37</sup> Ai kishte ikur nga Kruja e pushtuar, ku kishte vrarë një numër të madh të të vetëdorëzuarve dhe duke u falur jetën vetëm disave që kishin mundur të paguanin.<sup>38</sup> Venedikasit e mbrojtën qytetin me trimëri heroike, porse qenë të detyruar t'ua lëshonin atë turqve në paqen e

<sup>35</sup> *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë. Vëllimi II. Shek. VIII-XV.* Përgatitur nga: Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pipo. Tiranë: Univ. Shtetëror i Tiranës 1962, Nr. 249, f. 358. (Cituar si: *Burime. Vëll. II. Shek. VIII-XV, Nr., f.*)

<sup>36</sup> Oliver Jens Schmitt, "Die venezianischen Jahrbücher des Stefano Magno als Quelle zur albanischen und epirotischen Geschichte im Späten Mittelalter (1433-1477)", në: *Südosteuropa. Von Moderner Vielfalt und Nationalstaatlicher Vereinheitlichung.* Festschrift für Edgar Hösch Hrsg. v. Konrad Clewnig und Oliver Jens Schmitt. München: Oldenburg 2005. (Südosteuropäische Arbeiten 127. Für Südost-Institut München Hrsg. v. Edgar Hösch und Karl Nehring.), f. 179. (Cituar si: O. Schmitt, "Die venezianischen Jahrbücher der Stefano Magno", në: *Südosteuropa, f.*)

<sup>37</sup> K. Jireček, "Skutari und sein Gebiet im Mittelalter", në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 106.

<sup>38</sup> *Sipas Hammer-Purgstall të rrethuarit e Krujës, kur pas një viti rrethim, e panë se nuk kishin më asnjë rrugë tjetër shpëtimi dërguan delegatë tek sulltan Mehmeti II, me qëllim që të dorëzoheshin me të mirë. Ata morën nga sulltani një garanci me shkrim për jetën e tyre dhe për një largim të lirë duke u lënë të merrnin me vete edhe gjërat e tyre, nëse nuk do të dëshironin të jetonin më aty, të pashqetësuar, nën sundimin osman. Kështu ata iu dorëzuan një pashai me emrin Harun (apo Sulejman), i cili i lidhi këta me zinxhirë dhe i çoi para sulltanit. Sulltani ua preu kokat të gjithëve, duke lënë në jetë vetëm ata që ishin më fisnikët dhe që mundën të paguanin shuma të mëdha.* J. Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches 2*, f. 157-158.

bërë në vitin 1479, dhe nga 1600 ushtarë mbrojtës që kishin qenë në fillim të luftës kishin mbetur në fund vetëm 450 vetë.<sup>39</sup> Në fund të vitit (sipas një dokumenti të datës 20. 12. 1478) gratë e Shkodrës marrin ndihmë,<sup>40</sup> por ngaqë nuk e disponojmë dokumentin në fjalë nuk mund të themi se në çfarë konsistente kjo ndihmë.

Gjatë rrethimit të fundit të Shkodrës osmanët sollën në kampin turk 300 drishtjanë të zënë rob, të cilëve sulltan Mehmeti II ua preu kokat të gjithëve para mureve të Shkodrës, me qëllim që t'ua fuste frikën shkodranëve dhe venedikasve që gjendeshin të rrethuar brenda kështjellës, me qëllim që ata të pranonin kapitullimin.<sup>41</sup> Marin Sanodo i Riu në veprën e tij *“Jeta e Dukëve”* mbi këtë ngjarje tregon si më poshtë: *“Aty ishte si proveditor Jakob da Mosto; me tu pushtuar qyteti, turqit zunë da Moston dhe e hoqën zvarrë deri poshtë mureve të Shkodrës duke u propozuar të rrethuarve ta lironin kundrejt dorëzimit të qytetit. Por, kur propozimi u hodh poshtë, Pashai urdhëroi ta zhvishnin të sipërthënin Jakob da Mosto dhe ta ngulnin në hu mu përpara mureve të Shkodrës, në mënyrë që tu kallte tmerrin të rrethuarve. Pas këtij ekzekutimi të frikshëm të proveditorit, u shkuan në shpatë edhe 300 burra nga Drishti.”*<sup>42</sup> Megjithatë Shkodra u pushtua. Më 25 janar qe nënshkruar një traktat paqeje në Konstandinopojë midis Venedikut dhe osmanëve.<sup>43</sup> Kjo paqe u ratifikua më 25 prill 1479.<sup>44</sup> Me anë të kësaj paqeje Venediku qe i detyruar t'i njihte sulltanit zotërimin e Shkodrës, të Krujës dhe të qyteteve të tjera të pushtuara.<sup>45</sup> Të dy fuqitë zotoheshin t'i lëshonin njëra tjetrës disa toka që kishin pushtuar gjatë luftës dhe Venediku u detyrua t'i paguante Portës së Lartë një shumë prej 100.000 dukatësh dhe për çdo vit i duhej të derdhte 10.000 dukatë në shkëmbim të së drejtës së lirisë së

<sup>39</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 106.

<sup>40</sup> Z. Valentini, *Kontribute 1060-1560*, f. 169.

<sup>41</sup> Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 114.

<sup>42</sup> Lucia Nadin, *Shqiptarët në Venedik. Mërgim dhe integrim (1479-1552)*. Përktheu Pëllumb Xhufi. Tiranë: “55” 2008, f. 31. (Cituar si: L. Nadin, *Shqiptarët në Venedik*, f.).

<sup>43</sup> R. Matran, *Historia e Perandorisë Osmane*, f. 105.

<sup>44</sup> Aleks Buda, “Hyrje”, në: M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, f. 14.

<sup>45</sup> Po aty.

tregtisë në trojet e Perandorisë Osmane.<sup>46</sup> Pas traktatit të paqes më 25 janar me osmanët, Senati i Venedikut bëri një mbledhje më 25 shkurt (1479) dhe në vend që t'u dërgonte shkodranëve përforcimet ushtarake që ata pritinin, i dërgoi guvernatorit të Shkodrës, *da Lezze* një letër me përmbajtjen e mëposhtme:

*“Së pari ne duam që Ju tu deklaroni me fjalë të ëmbla dhe plot peshë atyre qytetarëve tanë shumë besnikë, se vendimi që kemi marrë është për të mirën dhe për më të përshtatshmen e tyre ... dhe duke marrë këtë vendim kemi pasur parasysh me tepër të mirën e personave sesa shtetin tonë (interesat e shtetit tonë). Dhe kështu kemi dashtë që për secilin të jetë në lirinë e tij ose të qëndrojë në shtëpinë e tij, ose të vij në trojet dhe në vendet tona e të jetojë nën hijen tonë. Dhe ata që do të rrinë, do të rrinë me hirin tonë të mirë dhe me dashurinë tonë dhe gjithmonë, në çdo rast do të jenë shumë të dashur për ne. Ata që në të vërtetë do të donin të niseshin për të ardhur tek ne, do të jenë të priturit më të favorizuar dhe do të akomodohen me mirësi dhe mbështetje të veçantë, dhe nga ana jonë nuk do t'u mungojë kurrë mëshira dhe hiri ynë atyre, me qëllim që ata me familjet e tyre të mund të jetojnë tek ne ashtu siç e kanë merituar prej besnikërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre.”<sup>47</sup>*

Pas pushtimit nga osmanët banorët e tjerë u lanë të lirë të iknin, dhe mesa duket shumica e tyre u vendos në territoret e Venedikut.<sup>48</sup> Ja si

<sup>46</sup> R. Matran, *Historia e Perandorisë Osmane*, f. 105.

<sup>47</sup> ASV Senato Secreta Reg. 28 155v: *“Volemo prima che vuy cum dolze humane et grave parole dechiarate a tuti quelli nostri fedelissimi Citadini chel partito che nuy hauemo prexo e stato për far il piu bene et comodo suo ... et hauemo in prender tal partito hauuoto piu respekto al bene et le persone sue cha dal stato proprio nostro. Et hauemo voluto chel sia in liberta de chiaschadun de loro cusiel remaner in caxa sua come nel venir ne le terre et luogi nostri et viuer soto l'ombra nostra. Et da mo quelli che romagnerano romagnerano cum bona nostra gratia et amore et sempre in ogni caxo ne sarano chiarissimi. Quelli veramente che volesseno partire a venir soto de nuy serano piu recolti favoriti et accomodati cum singular charita et begninita ne may li mancheremo de la gratia et clementia nostra per che cum le suo fameglie possano soto de nuy viuer come ha meritato la suo fede et Constantia.”*, në: O. Schmitt, *Das Venezianische Albanien*, f. 628.

<sup>48</sup> Theodor Ippen, *Shqipëria e Vjetër*. Studime gjeografike, etnografike, historike nga ish-konsulli i përgjithshëm i monarkisë austro-hungareze në Shkodër, përkthyer nga origjinali: Gjerak Karaiskaj, Ardian Klosi. Me riprodhimin e fotografimeve dhe skicave origjinale të Ippenit, Tiranë: K&B 2002, f. 183. (Cituar si: Th. Ippen, *Shqipëria e Vjetër*, f.).

i përshkruan Marin Barleti çastet e braktisjes së qytetit nga shkodranët e vjetër dhe hyrjes në kështjellë të osmanëve:

*“Ata u siguruen pra se turku as s’do ti prekte, as s’do t’u vente ndonji pusi, sadoqë këtij prap se prap s’i besohej edhe përsëri mund t’i vriste ose t’i dëmtonte randë në një mënyrë ose në një tjetër. Vetëm atëherë kur turqit dorëzuen disa njerëz të vet si peng me qëllim që të rrethuesit të dilnin të sigurtë dhe pa u prekë, si i thonë një fjale, as me pupël, vetëm atëherë shkodranët u a lëshuan qytetin. Edhe turqit aty për aty, plot gëzim e hare, midis brohoritjeve dhe duartrokitjeve u futën mbrendë në qytet tue u endë andej e këtej ngulën flamujt e tyne në të katër anët: i dhanë shfrim qejfit të vet, (siç e kanë zakon në raste të tilla) me trumbeta, me daulle e me sa e sa instrumente të tjera; entuziazmi i tyne ishte i pamasë, po çmendeshin nga gëzimi që shtinë në dorë Shkodrën. Nga ana tjetër shkodranët lanë qytet e atdhe edhe të gjithë së bashku me plaçka e orendi u drejtuen të sigurtë te flota që kishte zanë vend pesë milje larg qytetit.”<sup>49</sup>*

Qytetarët e Shkodrës nën drejtimin e udhëheqësit të tyre Florio Jonima u shpërngulën përveçse në Venedik, edhe në Ravenë e Treviso që atëherë (pra që në vitin 1479).<sup>50</sup> Ky shtet që siç mësohet nga burimet e ndryshme u mundua t’i sistemonte sipas mundësive të ikurit nga Shkodra dhe nga qytetet e tjera të Shqipërisë mesjetare. Beçikemi e përshkruan grupin e shkodranëve të sapoarritur si më poshtë: *“Ne shkodranët, siç mbetëm të mërguar, erdhëm në Venedik; shtatëqind burra, njëmijë e treqind fëmijë dhe aq gra: kaq, pra kishim mbetë gjallë prej gjithë asaj popullsie”*.<sup>51</sup> Më vonë, qeveritari venedikas në Shkodër Antonio da Lecce, disa kohë pasi ishte shpërblyer për merita në mbrojtjen e Shkodrës nga Senati, u nxorr para gjyqit dhe u dënua me burg e internim dhe me humbjen e pasurisë dhe të titujve, pasi ai e kishte informuar qeverinë e Venedikut për mungesë rezervash ushqimore, ndërkohë që, sipas thënieve të shkodranëve të emigruar atje, qyteti kishte patur mjaft rezerva ushqimore për të vazhduar qëndresën.<sup>52</sup>

<sup>49</sup> Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, f. 109.

<sup>50</sup> Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen* I, f. 106.

<sup>51</sup> Marin Beçikemi, “Panegjirik i Marin Beçikemit Shkodran (drejtue shumë të kthiellitit dogjë Leonard Loredanit dhe shumë të ndriçmit Senat të Venedikut”, në: M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, f. 141.

<sup>52</sup> Aleks Buda, “Hyrje”, në: M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, f. 16.

Lufta për pushtimin e Shkodrës nuk qe një luftë e mënyrës së vjetër feudale, por një luftë ku u vunë në veprim armë të rënda të artilerisë. Këtu mund të përmendim 11 topat e mëdhenj, dhe njëri prej tyre mund të gjuante një gjyle me peshë deri në 600 kg.<sup>53</sup> “Vetë në një ditë, më 11 korrik, këto topa arritën të hidhnin deri në 178 gjyle – një numër kolosal, i panjohur deri atëherë për teknikën e kohës.”<sup>54</sup>

Në vitin 1498 në Shkodër nga pushtuesit osmanë ishte vendosur Feris Bej, si sanxhakbej i Shkodrës.<sup>55</sup> Shkodra mbeti për 434 vjet nën sundimin turk, deri më 1913.<sup>56</sup> Por, pushtimi nuk mbeti vetëm në Shkodër. Ai u shtri edhe në zonat përreth. Në Shkodër u vendos një sanxhakbej osman, i cili ishte më se i vetëdijshëm për pushtetin e tij.<sup>57</sup> Vala e pushtimit sigurisht që nuk u përqendrua vetëm në Shkodër por goditi edhe qytete të tjera që ndodheshin në afërsi. Këtu e kemi fjalën për qytetet Drisht, (Deja ishte shkatërruar qysh me Rrethimin e Parë të Shkodrës), Lezhë dhe afro një shekull më vonë edhe të qyteteve Ulqin dhe Tivar. Kurse qytetet Balec, Sardë dhe manastiri e Shën Gjonit në afërsi të Balecit (në Rrashkullaj) ishin braktisur dhe shkatërruar shumë kohë më përpara.

Kishat e shumta të Shkodrës u shkatërruan ose u transformuan në objekte me funksione të tjera. Ndër to mund të përmendim katedralen e Shën Shtjefnit që gjendej brenda kështjellës, që ishte një vend i famshëm pelegrinazhi dhe që u kthye në xhami\*; kishën famullitare të Shën Kollit që gjendej po ashtu brenda kështjellës, kishën e Shën Kollit afër portës së qytetit (*San Nicolo appresso la Porta*), e cila u godit me top dhe u shkatërrua gjatë Rrethimit të Dytë,<sup>58</sup> ku Helena, e veja e mbretit Stefan Urosh I, qethi flokët për t’u bërë murgeshë; kishat *Shën Aponale* dhe “*Të gjithë Shenjtorët*” (*Ogni Santi*), si dhe dy kisha që në shek. XV ishin tashmë rrënoja, Shën Teodori dhe Shën Kryqi, të cilat ndodheshin jashtë mureve të qytetit; Kishën e Shën Vlashit (Blasius) (*extra Scutari ad S.*

<sup>53</sup> Po aty, f. 14.

<sup>54</sup> Po aty.

<sup>55</sup> Z. Valentini, *Kontribute 1060-1560*, f. 172.

<sup>56</sup> K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 106.

<sup>57</sup> O. Schmitt, *Das Venezianische Albanien*, f. 629.

\* Sot rrënojat e saj gjenden brenda kështjellës Rozafat, në (oborrin e parë. – E. M).

<sup>58</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, f. 85.

*Blasium 1433, S. Blasius prope civitatem Scutari 1444*) e gjendur në varoshin e quajtur Nën-Shkodër (Sub-Scutaro), pra në lagjen e tregtarëve raguzanë, që rreth kësaj periudhe, (shek. XV), ishte një kishë manastiri, që i përkiste mesa duket minoritëve.<sup>59</sup> Kjo kishë u kthye në banjë turke dhe si e tillë i rezistoi kohës deri në shek. XX, dhe u prish pastaj nga regjimi komunist.

Po ashtu u shkatërrua edhe manastiri benediktin i Shën Shirgjit (*Sergius*) dhe Shën Bakut (*Bacus*) në Bunë, që kishte shërbyer si port lumor dhe si vend kishte qenë strategjikisht shumë i rëndësishëm. Edhe pse vala e shkatërrimit për këtë manastir kishte filluar që gjatë luftërave që u bënë ndërmjet Venedikut dhe despotëve serbë, prapëseprapë vuajtjet më të mëdha ky manastir i pati gjatë luftës që u bë për Shkodrën ndërmjet Venedikut dhe turqve.<sup>60</sup> Me pushtimin turk, abacia u shkretua tërësisht.<sup>61</sup>

Sot Shën Shirgji është një rrënojë e shkretë. Nga manastiri i dikurshëm ka mbetur vetëm një copë mur, i cili rrezikohet nga ujërat e Bunës, pasi erozioni ka avancuar deri në afërsi të këtij muri. Po ashtu jemi të mendimit se gjatë pushtimit turk u shkatërrua edhe abacia e Shën Kollit të Bunës, apo “Abacia Benediktine e Shën Kollit të Drinit”\* (*San Nicoli de Drino*), që përmendet për herë të parë në shek. XIV dhe që ndodhej në grykëderdhje të Bunës.<sup>62</sup> Megjithatë mbi shkatërrimin e kësaj abacie, nuk kemi akoma të dhëna që na e pasqyrojnë këtë. Sot në vendin

<sup>59</sup> Të dhënat mbi kishat e Shkodrës marrë nga Milan v. Šufflay, “Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damme”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 262-263. (Cituar si: M. Šufflay, “Kirchenzustände”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 263.)

<sup>60</sup> Po aty, f. 269-270.

<sup>61</sup> Po aty, f. 270.

\* Kisha e Shënkollit sot ndodhet në Shtoj të Ulqinit, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në kufi me krahinën e Velipojës.

<sup>62</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MCMXIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 613, f. 182. (Cituar si: AAlb. I, nr. i dokumentit, f.)

ku ndodhej ky manastir është ndërtuar një kishë e re që i dedikohet po ashtu Shën Kollit, dhe aty shihen vetëm disa mbetje muresh, për të cilat supozojmë se i përkasin kishës apo manastirit të vjetër.

Nga pushtimi osman gjeti shkatërrimin edhe arqipeshkvia e Krajës me kishën “E papërlyera e Krajës” që ndodhej disa orë larg Shkodrës, dhe për të cilën kleri katolik (- si figurë kryesore mund të përmendet këtu arqipeshkvi i Krajës Pal Dushi [*Paulus Dussius*]) luftoi aq shumë që të mos përfundonte si kishë skizmatike sllave. Ostrosi me shumë fshatra të tjerë të Krajës, pas pushtimit osman u kthye në islamizëm dhe siç thotë Shuflai “Kishën e mbuloi bari” gjatë shekullit XVII, por kultu mbijetoi ndër shekuj dhe “Kryqi i Krajës” ruhet sot në fshatin Veljo Mikuliqi në zonën e Mërkojeviqve, ndërmjet Ulqinit dhe Tivarit.<sup>63</sup>

Përsa i përket ngjarjeve brenda Shkodrës në dekadat e para të pushtimit kemi shumë pak të dhëna. Ajo u kthye në një qendër administrative ushtarake, por ngaqë kishte një pozicion gjeografik të favorshëm, ku pranë saj kalonin rrugë, me liqenin dhe me lumenj që ishin plot me dajlane peshkimi, qe e destinuar të ringjallej. Në vitin 1501 ekzistonte tashmë, edhe tregu.<sup>64</sup> Qyteti 50 vjet pas pushtimit kishte nisur të rimëkëmbej, por kjo rimëkëmbje qe shumë e ngadaltë ngaqë qyteti në fillimin e shek. XVI, pësoi një djegie masive nga vetëtimat dhe në vitin 1570 edhe një djegie tjetër nga një aksion i malësorëve shqiptarë<sup>65</sup>, të cilët e shihnin Shkodrën osmane tashmë si qendër ushtarake armike ndaj ekzistencës së tyre. Në vitin 1614, Bolica në një relacion të tij, numrin e shtëpive të Shkodrës (qyteti së bashku me varoshin) e jep afërsisht 400 shtëpi, nga të cilat dilnin 1000 burra të armatosur.<sup>66</sup> Po të shohim Shkodrën e Kadastrës së viteve 1416-1417, nën juridiksionin e së cilës

<sup>63</sup> Milan Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët*. Përktheu nga kroatishtja: prof. dr. Hasan Çipuri. Tiranë: “Toena” 2004, f. 128.

<sup>64</sup> Stavri N. Naçi, *Pashalleku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllive në gjysmën e dytë të shekullit të XVIII (1757 - 1796)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë 1964, f. 36. (Cituar më tej si: S. Naçi, *Pashalleku i Shkodrës*, f.)

<sup>65</sup> *Po aty*, f. 37.

<sup>66</sup> “*La bella e fortie piazza di Scutari, situata sopra ad una collina à piedi del lago e del fiume Boiana, la città col borgo puo fare case quattrocento et gente armate mille.*”. Relacion I M. Bolicës, në: *Po aty*, 37, ref. 38.

numëroheshin rreth 116 fshatra<sup>67</sup>, dhe atë të vitit 1614 me 400 shtëpi, vëmë re dëmin e madh që pushtimi osman (por përveç këtij edhe fatkeqësi të tjera) i solli këtij qyteti. Përsa i përket fshatrave kemi një zvogëlim të ndjeshëm të numrit të tyre që në dhjetëvjeçarin e parë të pushtimit. Për shembull për vitin 1485 në defterin e Sanxhakut të Shkodrës janë të shënuar vetëm 77 vendbanime apo fshatra që vareshin nga Shkodra,<sup>68</sup> pra aty mungojnë 39 fshatra (pra 1/3 e tyre) që 68 vite më parë kishin ekzistuar dhe që gjenden në kadastrën e vitit 1416-1417.

### **Pushtimi i Drishtit**

Megjithëse Drishti, kishte pasur gjatë shek. XV meremetime të ndryshme të mureve dhe fortifikimi, megjithëse pozicioni i tij mbi kodër është i atillë sa që nuk mund të arrihet lehtë, ai nuk mundi t'i bënte ballë vërshimit të vrullshëm të hordhive pushtuese osmane. Drishti u pushtua nga osmanët më 1 shtator të vitit 1478, pas një rrethimi dhe gjuajtjeje me topa prej 16 ditësh.<sup>69</sup> Si shkas i pushtimit të Drishtit ishte dështimi i sulmit të dytë mbi Shkodrën që ndodhi nën prezencën e sulltan Mehmetit II. Në këshillin e luftës të mbledhur nën muret e Shkodrës u vendos që para se të vazhdohej me sulmin mbi kështjellën Rozafat, të pushtoheshin më parë disa kështjella përreth që ishin akoma në duar të kundërshtarit. Këto kështjella ishin Zhabljaku (turq. *Shavibeg*), i cili u mor nga osmanët pa rezistencë dhe në mënyrë të turpshme siç e përshkruan Hammer-Purgshtal<sup>70</sup> dhe Barleti, dhe Drishti (turq. *Dergos*, apo *Dergof*\*) i cili bëri rezistencë. Ndërsa kështjella e Virpazarit, (mesa duket në turqisht e

<sup>67</sup> Pranvera Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve dhe e sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV*. (Disertacion për kërkimin e gradës shkencore “Kandidat i Shkencave Historike”) profesor udhëheqës Aleks Buda. Tiranë: Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë 1984. (A-III-503, Nr. inv 3078), f. 23.

<sup>68</sup> Spiro Shkurti, *Bujqësia në Arbërinë e shek. XIII-XVII*, Akademia e Shkencave. Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë: 2002, f. 264.

<sup>69</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, f. 100. *Sipas Ermao Armanos Drishti ra në dorën e osmanëve në vitin 1477*. Ermano Armao, *Vende, Kisha lumenj, male e toponime të ndryshme të një harte të lashtë të Shqipërisë veriore*. Tiranë: “Korbi”, 2006, f. 73. (Cituar si: E. Armao, *Vende, Kisha lumenj*, f.)

<sup>70</sup> J. Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches* 2, f. 164.

\* Turqisht *Dergos*, apo *Dergof* për Drishtin përdoren nga dy kronistë osmanë të quajtur Seadetin dhe Haxhi Halfa i Rumelisë. *Shih për këtë*: J. Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches* 2, f. 154.

quajtur *Gëlbashi* “Koka, apo fillimi i Liqenit”), në atë kohë ishte tashmë e shkatërruar.

Një përshkrim të dorës së parë të rrethimit e të pushtimit të Drishtit e jep Marin Barleti duke dhënë dëshmi të rëndësishme mbi shkatërrimin dhe masakrimin e popullsisë: “*Pasha, mbasi ia preu shtegun repartit ma të fortë të krishterëve tu e lanë jashtë qytetit, vendosi artilerinë në pozicionet e duhuna dhe me të filloi të shembë muret e qytetit nga ajo anë në të cilën ledhet ish-in ma të dobëta dhe mund të rrënoheshin ma me lehtësi. Mbasi ledhet u rrafshuen për dhé brenda gjashtëmbëdhjetë ditëve, vetë sulltani me datën 31 gusht erdhi për të shti në dorë qytetin që do të merrej të nesërmen. Dhe me të vërtetë me 1 shtator, porsa zbardhi drita, u dha shenja edhe barbarët iu vërsulën nga të katër anët qytetit dhe iu futën brenda pa farë vështirësi, së pari sepse nuk pati kush ti përballonte e pastaj sepse muret e fortifikimet ish-in shembë fare.*

*Duhet dijtë se ajo kështjellë kishte një rreth të madh; mbasandaj të gjithë djelmohat që mund të ish-in një tetëqind vetë (sikurse u tha ma nalt), kishin mbetë jashtë qytetit. Veç asaj, ata që ish-in brenda në qytet dita e ditës dhetoheshin nga murtaja. Ata pak vetë që u orvatën m’e shporrë anmikun prej ledheve, u vranë e u prenë një nga një. U zunë të gjallë një treqind vetë dhe me datë 2 shtator i çuen ndër shatorre; pastaj me urdhën të sulltanit të gjithë u vranë përnjëherë ndër sy të shkodranëve.”<sup>71</sup> Pra siç e shpreh edhe vetë Marin Barleti, qyteti gjatë këtij rrethimi u mundua shumë edhe nga murtaja, e cili shkaktoi një dobësim të mbrojtjes.*

Mbi pushtimin e Drishtit shkruan edhe kronisti turk Mynexhim Bashi. Pra ngaqë Drishti së bashku me Zhabjakun dhe Lezhën bënte pjesë në sistemin mbrojtës të Shkodrës, u pa strategjikisht e nevojshme që më parë të pushtoheshin këto kështjella. Drishtin e rrethoi Sulejman Pasha, Bejlerbegu i Anadollit, por atij iu bashkua edhe Daut Pasha, pasi kishte pushtuar tashmë kështjellën e Zhabjakut.<sup>72</sup> Banorët e vjetër të Drishtit, sipas Nopçës, “*thonë që erdhën dhe u vendosën përreth vendit të tyre nga të gjithë anët.*”<sup>73</sup>

<sup>71</sup> M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, f. 100.

<sup>72</sup> *Burime. Vëll. II. Shek. VIII-XV*, Nr. 249, f. 358.

<sup>73</sup> Franc Baron von Nopça, *Shqipëria. Fiset e malësisë së Shqipërisë (kanuni) prej Dr. Franz Baron Nopça*, material i pabotuar, përkthyer nga Petraq Zallari. Biblioteka Kombëtare Austriake. Photo Nr. M 1263. 63 SER.NOV. 9392.

Sipas gojëdhënave në Drisht ndodhej edhe Lekë Dukagjini me Pal Dukagjinin dhe mbi këta të dy mbi pushtimin e Drishtit tregohet në legjendën e sjellë nga Nopça, si më poshtë: *“Përmbi rrethimin dhe pushtimin e Drishtit, që përmendet historikisht për të parën herë në vitin 1087, dhe që u pushtua nga turqit në 1478, kam dëgjuar këtë gojëdhënë: Kur Lekë Dukagjini mbrohej në Drisht kundër turqëveve, duke ndjekur këshillën e Pal Dukagjinit të verbuar, zbrazi një top, të mbushur me të holla ari, kundër turqëveve, por kjo nuk pati sukses, se turqit i përdornë të hollat, për të blerë ushqime dhe për të shuar urin e tyre; rrethimi kështu vazhdoi.*

*Më von bile zunë rob gruan e Lekës dhe kërcënoheshin t’u vrisnin. Atëherë ajo nga frika tradhëtoi, që faqja e djathtë e murit të kështjellës, nuk ishte prej guri por prej lëkure buallicash të spërkatura me llaç. Pas kësaj tradhëtie mundnë turqit të hynin në Drisht, dhe Leka u detyrua të arratisëj. – U arratis në lindje dhe thuhet, që merturasit qenkan pasardhësit e tyre. Historikisht dihet që i tërë garnizoni i Drishtit u vra nga turqit përpara murevet të Shkodrës. Pas arratisjes së Lekë Dukagjinit, i cili, siç thuhet, nga Drishti ka ikur te Guri i Lekës në Shosh dhe pastaj gjat Drinit te Ura e Vezirit.”<sup>74</sup>*

Drishti ra si qytet, me kalimin e kohës u rrënua plotësisht duke pësuar fatin e shumë qyteteve të tjera që ndodheshin aty përreth, si Sardës, Sapës, Balezos Shasit, etj., dhe nuk u ripërtëri kurrë më.<sup>75</sup>

Pas pushtimit osman në kala duket se u vendosen kalorës spahinj, të cilëve iu dhuruan timare në krahinat përreth. Sipas Nopçës, që i referohet të thënave gojore të banorëve të Drishtit në fillim të shek. XX, pjesa më e madhe e banorëve të fshatit Drisht vetë thonë se rrjedhin

<sup>74</sup> *Po aty. Krah. për këtë edhe tekstin origjinal të Nopçës tek: F. Nopcsa, “Die Bergstämme Nordalbaniens”, në: Fatos Baxhaku dhe Karl Kaser, Die Stammesgesellschaften Nordalbaniens. Berichte und Forschungen österreichischer Konsuln und Gelehrter (1861-1917). Wien/Köln/Weimar: Böhlau 1996, f. 245-246. (Cituar si: F. Nopcsa, “Die Bergstämme Nordalbaniens”, në: Baxhaku/Kaser, Die Stammesgesellschaften Nordalbaniens, f.)*

<sup>75</sup> Konstantin Jireček, “Albanien in der Vergangenheit”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [u. a.]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 83. (Cituar si: K. Jireček, “Albanien in der Vergangenheit”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f.)

drejtpërsëdrejti nga osmanllinjë, të cilët, pasi u rrënuar kështjella e Drishtit u vendosën aty në vendin që kishte mbetur tashmë pa banorë.<sup>76</sup> Këta timarxhinj morën emërtimin “*Mbrojtës të kalasë së Drishtit*” dhe këtë e mësojmë nga “*Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës, për vitin 1485*”<sup>77</sup>. Këta “mbrojtës” të Kalasë së Drishtit me timaret e tyre po i radhisim si më poshtë: *Hasan Agai, Mustafai, kethyda i kalasë së Drishtit; Hamza Debri, Jusuf Zerdi, Sulejman Matja, Salih Myezini, Ahmed Radomiri, Karagjoz Mura dhe Pir Aliu i biri i Kolës Hamzai, Hasani i biri i Kolës, Iljaz Klina, Hamzai (person tjetër) Ukça Boli*.<sup>78</sup>

Në listën e mësipërme u përmendën vetëm të ashtuquajturit “mbrojtësit e brendshëm” pa përmendur të jashtëmit, timaret e të cilëve i kaluan Shkodrës. Nga Drishti varej edhe fshati Bleshja, me shtatë shtëpi të krishtera, fshat shumë i vjetër ky, që solli 500 akçe për vitin 1485.<sup>79</sup> Sot këtë fshat nuk mund ta lokalizojmë se ku ndodhej. Ngaqë vendi ishte boshatisur nga banorët këto timare ishin të organizuara si timare të përbashkëta (*myshterek*).<sup>80</sup>

Këta timarxhinj, ndër të cilët vëmë re edhe ish- të krishterë të sapo konvertuar në Islam (p. sh. Hasani i biri i Kolës, apo Pir Aliu, i biri i Kolës, etj.) për të përfituar timare, ishin spahinj dhe me anë të administrimit mizor të tyre çuan në shkretimin e këtyre fshatrave, deri sa popullsia e atyshme që detyruar të largohej. Këtu mund të përmendim fshatrat Prekal (në fund të ekzistencës së tij i përbërë nga katër shtëpi) dhe Luk (Lok), të cilët më parë kishin qenë në varësi të Drishtit, porse ishin goditur e shkatërruar plotësisht.<sup>81</sup>

Taksat ishin të llojeve të ndryshme si taksa e ispenxhës, e cila ishte taksa kryesore që i jepej spahiut si zotërues i *rajasë*, (duke përfshirë këtu ispenxhën e kryefamiljarëve, ispenxhën e beqarëve që kishin arritur moshën e pjekurisë, dhe ispenxhën e të vejave), pastaj vinte e *dhjeta* e prodhimeve bujqësore (*oşür*) që spahiu vilte si zotërues i tokës (këtu

<sup>76</sup> F. Nopcsa, “Die Bergstämme Nordalbanians”, në: Baxhaku/Kaser, *Die Stammesgesellschaften Nordalbanians*, f. 245.

<sup>77</sup> *Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*. Paraqitja, hyrja, transliterimi, përkthimi dhe komentet nga Selami Pulaha, Akademia e Shkencave e R.P. të Shqipërisë, Tiranë: 1974, f. 397 (Cituar si: *Defteri 1485*, f.).

<sup>78</sup> *Po aty*, f. 397-405.

<sup>79</sup> *Po aty*, f. 395.

<sup>80</sup> *Po aty*, f. 12.

<sup>81</sup> *Po aty*, f. 379, 365.

përfshiheshin të gjitha llojet e drithërave, fiqtë, ullinjë, perimet, mushti, etj.), pastaj e dhjeta e peshkut, e dhjeta e bletëve, pastaj taksa e kullotës, taksa e druve, taksa e govatës.<sup>82</sup>

Në dobi të spahinjve ishin llogaritur dhe vënë gjithashtu edhe taksa të tjera, si taksa e *nijabetit*, taksa e *martesës (resmi gerdek)*, *badihava* të tjera, si dhe *bidati i derrave*.<sup>83</sup> Kështu, si rrjedhojë e gjithë këtyre taksave u braktisën fshatrat dhe u shkretua më tej edhe qyteti, deri sa nuk mbeti askush më. Në vitin 1485, përveç timarlinjve spahinj, mbrojtës të Drishtit, që i përmendëm më sipër, për të cilët presupozojmë se duhet të kenë jetuar në kështjellë, janë edhe 16 shtëpi të krishtera të cilat ndodheshin në varoshin e kalasë, dhe nga këto, gjashtë kishin në duart e tyre vendimin sulltanor për faljen e taksave, meqenëse ishin caktuar për kryerjen e shërbimeve të ndryshme në kala.<sup>84</sup> Emrat e kryefamiljarëve të këtyre 6 shtëpive janë: *Gjergji, i biri i Dobrosit; Stepiani, i biri i Bardos; Domeniku, i biri i Kuçit; Petri, i biri i Preimit; Gjoni, i biri i Dobrosit; Gjoni Dobrosi tjetër*.<sup>85</sup>

Kurse emrat e kryefamiljarëve të tjerë të krishterë, banues në Varosh, që nuk ishin të falur nga taksat janë: *Gjergj Zhupa; Gjergj Dobrosi (tjetër); Gjergj Menka; Petri, i biri i Malçkos; Luka Velça; Gjoni Dobrosi; Nikolla Dobrosi (Dobrosi); Gjergj Dobrosi; Andrija Gradini; Dhimitër Bukmiri*.<sup>86</sup> Si nahije, në fund të shek. XV, Drishti numëronte rreth 16 shtëpi dhe dhjetë nga emrat e kryefamiljarëve të këtyre shtëpive janë si më poshtë: *Gjergj Zhupa; Nikolla Dobrosi (Dobrosi); Gjoni Dobrosi; Andrija Gradini; Gjergj Dobrosi; Gjergj Dobrosi (tjetër); Gjergji, i biri i Dobrosit; Stepiani, i biri Bardos; Gjoni, i biri i Dobrosit; Gjoni Dobrosi tjetër*.<sup>87</sup>

Këta nxorën si të ardhura 500 akçe për vitin 1485, kurse po për këtë vit për vetë Drishtin kësti i *baxhi bazarit* dhe i *taksës së gjerdekut*, dhe e dhjeta e vreshtave së bashku me taksën e peshkatarëve dhe drurët e ullinjve hasa dhe të tjera, arriti shumën 28.000 akçe.<sup>88</sup> Në vitin 1614

<sup>82</sup> S. Pulaha, "Hyrje", në: *Defteri 1485*, f.15.

<sup>83</sup> Po aty, f.15.

<sup>84</sup> Po aty, f. 137.

<sup>85</sup> Po aty, f. 137.

<sup>86</sup> Po aty, f. 136.

<sup>87</sup> Selami Pulaha, "Elementi me onomastikë shqiptare", në: *Studime Historike*, 4, Tiranë: 1972, f. 202.

<sup>88</sup> *Defteri 1485*, f. 136.

Françesko Bolica (Francesco Bollizza) Drishtin e përshkruan si qytezë të fortifikuar, porse jo shumë të banuar. Përshkrimin e Bolicës, nga që është një dokument pothuaj 400 vjeçar po e japim si më poshtë:

*“Qyteti i Drishtit është i vendosur në anën e një mali, i rrethuar nga male me një kështjellë në majë të njërit mal që i rri sipër qytetit .... me lagjen, përreth ka piacën jo të banuar shumë, megjithatë në lagje ka shtëpi të banuara, në krahasim me rrafshinën poshtë që është pjellore dhe e kultivuar. Është larg 12 milje nga Shkodra dhe ka pranë dy fshatra, jo shumë të mëdhenj. Ky ishte ndër qytetet kryesorë të Shqipërisë, dhe aty kishte rezidencën një mbiproveditor për shumë të kthjelltën Sinjori të Venecies, vendimet gjyqsore të të cilit shkonin dhe shqyrtoheshin në Kotorr.”<sup>89</sup>*

Ndërsa Gezzi Bianco në një relacion të vitit 1621 kalon nga Drishti, por nuk na jep asnjë informacion në lidhje me popullsinë aty, veçse përmend Drishtin si dioqezë bosh (vakante), pra pa prani të krishterësh dhe kishash, dhe pa ipeshkëv.<sup>90</sup>

Pushtimi i Drishtit nga turqit mbeti i gjallë në popullsinë vendase myslimane shqiptare deri në fillim të shek. XX, sepse aty në afërsi të fshatit që ishte krijuar në rrjedhën e shekujve pas shkatërrimit të qytetit, sipas Ippenit, ndodhej një *tyrbe* e një luftëtari “të shquar” turk, i cili pati rënë në luftë kundër drishtjanëve, gjatë kohës së rrethimit dhe besimtarët myslimanë, sipas zakonisht, këtyre luftëtarëve që kishin rënë në luftë “kundër të pafeve” u jepnin titullin e nderit *shehit*, dhe “shehiti i Drishtit”

<sup>89</sup> *“La citta di Drivasto situata alla falde di un monte, circondata da monti con un castello in cima d’uno, che soprasta alla citta a guiza, ha quello di cattaro, col borgo attorno piazza forte non abitata pero molto, benche nel borgo vi siano case abitate rispetto al piano si siede sotto coltivato e fertilissimo. Distante ta Scutari per 12 miglia ha apresso due villaggi, non troppo grossi. Fu citta principalissima d’Albania dove risiedeva un sopraproveditore per la Serenissima Signoria di Venezia dal quale le sentence da Cattarro andavano in Apellazione.”* Descrizione di Scutari, Dolcigno et altri loughi per Francesco Bollizza. Fu scritta l’anno 1614 Copia tratta dal originale che si conserva nell’ archivio di Statoa Venezia e da me fatia copiare. Miscellanea Codici Nr. 254, f. 16.

<sup>90</sup> Fulvio Cordignano, *Geografia Ecclesiastica dell’ Albania. Dagli ultimo decennio del secolo XVI alla metà del secolo XVII*. Roma: Pont. Institutum Orientalium Studiorum, në: *Orientalia Christiana*. Vol. XXXVI-4. Num. 99/ Decembri 1934, f. 15.

e kishte patur emrin Kamber.<sup>91</sup> Tyrbja e tij ruhej (Tyrbja e Kamber Babës), sipas Ippenit, nga një tyrbedar i sektit të dervishëve bektashinj dhe aty bëhej për çdo vit pelegrinazh nga myslimanët e Shkodrës, të cilët shkonin me shumicë.<sup>92</sup> Në lidhje me qytetin e Balcit mund të thuhet, se nuk i përjetoi dilemat e pushtimit, pasi në vitet 70 të shek. XV ky qytet ishte tashmë i braktisur.

### **Pushtimi i Lezhës**

Edhe Lezha nuk pati një fat më të mirë pas pushtimit, ngaqë atë gjithashtu e përfshiu vala e shkatërrimit. “Mehmeti e pushtoi edhe Lezhën urdhëroi të hapej varri i njeriut të cilit i qe trembur aq shumë dikur dhe eshtrat e tij të nxirreshin përjashta për t’i parë të gjithë.”<sup>93</sup> Në lidhje me pushtimin e Lezhës, duhet të thuhet këtu që ishte një dorëzim i qytetit në dorën e turqve dhe ikje e banorëve si në Shkodër. Kur turqit pushtuan Lezhën në vitin 1478, ata e thyen varrin e Skënderbeut brenda Kishës së Shënkollit dhe i shpërndanë kockat e udhëheqësit të famshëm në të gjitha drejtimit, për t’i përdorur si talismane.<sup>94</sup>

Në vijim po japim edhe një dokument, shënim nga ditari i Marino Sanudos, që e dëshmon nga çfarë u tha më sipër: “Nga Lezha (Letër) e Z. Domeniko Dolfinit, kapiten i galerave bastarde dhe e Z. Almorro Pizani, sovraomit e nënkapiten i Gjirit. (Tregojnë) se, sipas urdhëresave, zbritën në Lezhë dhe u treguan atyre (banorëve) mendimin e Sinjorisë që ai vend t’i jepet sulltanit. Ata donin të mbroheshin (por) më në fund, u hoqën artileritë dhe vendasit dhe gjithë vendit iu dha zjarri. Banorët pjesërisht kërkuan të shkonin në Ulqin e pjesërisht gjetkë në Pulje. Kështu që vendi qe djegur e qe bërë i pabanuar.”<sup>95</sup> Zjarrin qytetit ia vuri pashai i Rumelisë dhe kjo duhet të ketë ndodhur më 9 shtator 1478.<sup>96</sup> Kur ushtria e këtij të fundit u kthye në Shkodër solli me vete 50 të kapur rob në një anije venedikase dhe shumë të tjerë në ishullin e Drinit, të cilët pastaj i sollën

<sup>91</sup> Th. Ippen, “Malësia e Shqipërisë Veriperëndimore”, në: *Shqipëria e Vjetër*, f. 40.

<sup>92</sup> Po aty, f. 41.

<sup>93</sup> Franc Babinger, *Mehmet Pushtuesi. Botësulmuesi në kapercyell kohe*. Vëllim i Parë. Përkthyer shqip nga Afrim Koçi. Tiranë: “55”, f. 382.

<sup>94</sup> Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 123.

<sup>95</sup> *Burime*. Vëll. II. Shek. VIII-XV, Nr. 362, f. 366.

<sup>96</sup> Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches 2*, f. 164.

para mureve të Shkodrës dhe i vranë.<sup>97</sup> Ishulli i Drinit që përmendet këtu nga Barleti mbase është vendi i quajtur sot “*Ishulli i Lezhës*”. Sot aty nuk ka ishull, por ndoshta një i tillë ka ekzistuar gjatë shek. XV, kur rrjedha kryesore e Drinit ka kaluar nga Lezha.

### **Shasi**

Shasi në kohërat e pushtimeve osmane ishte tashmë i braktisur dhe i rrënuar. Megjithatë në lidhje me gjendjen e tij gjatë shek. XX, mund të thuhet që muret e qytetit në vitin 1406 ishin në një gjendje aq të keqe, sa që ipeshkvi si i dërguar i bashkësisë së qytetit në Venedik u lut për t’u lejuar “që të fortifikoheshin muret e atij qyteti (*fortificare et murare locum illum*)”<sup>98</sup>, meqë turqit po plaçkitnin në zonat përreth dhe raguzanët i japin 1413 ipeshkvit tjegullat për të mbuluar çatinë e kishës.<sup>99</sup> Pra, në fillim të shek. të XV ky qytet ishte i banueshëm dhe i braktisur kohë më parë.

### **Pushtimi i Ulqinit dhe i Tivarit**

Pas rënies së Shkodrës, Ulqini dhe Tivari qëndruan nën sundimin venedikas për gati një shekull.<sup>100</sup> Ulqini u pushtua nga osmanët në vitin 1571,<sup>101</sup> dhe në të njëjtin vit u pushtua edhe Tivari.<sup>102</sup> “*Për shkak të rezistencës luftarake sanxhakbeu i Shkodrës i vuri zjarrin Ulqinit. Përveç kësaj ai vrau edhe një pjesë të qytetarëve dhe pjesën tjetër, me gra e fëmijë i bëri robër.*”<sup>103</sup> Kurse Tivari që u pushtua po atë vit, nuk u shkatërrua për shkak se qyteti iu dorëzua pa luftë trupave osmane të komanduara nga sanxhakbeu i Shkodrës, ngaqë aty kishin plasur grindje të brendshme midis “popullorëve” dhe “fisnikëve”.<sup>104</sup> “*Pushtuesit turq,*

<sup>97</sup> Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, f. 101.

<sup>98</sup> Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 120.

<sup>99</sup> Po aty.

<sup>100</sup> S. Naçi, *Pashallëku i Shkodrës*, f. 39.

<sup>101</sup> Gëzim Hoxha dhe Nail Draga, “Ulqini”, në: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*. Botim i Ri. Vëll. III, Akademia e Shkencave të Shqipërisë / Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Tiranë: “Kristalina-KH”, 2009, f. 2798. (Hoxha/Draga, “Ulqini”, në: *Fjalor Enciklopedik Shqiptar. Vëll. III.*, f.)

<sup>102</sup> Bogdani, “Tivari”, në: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Vëll. III, f. 2717.

<sup>103</sup> S. Naçi, *Pashallëku i Shkodrës*, f. 39.

<sup>104</sup> Po aty.

*sapo hynë brenda, ashtu sikurse kishin vepruar edhe në Shkodër, dëshmon Pjetër Bogdani, kthyen katedralen e Shën Gjergjit në xhami, zaptuan të ardhurat e kryepeshkopatës dhe rrënuan ndërtesat e banimit të saj.*<sup>105</sup> Qytetet Ulqin dhe Tivar me fshatrat përreth tyre u bënë pastaj kaza të sanxhakut të Shkodrës.<sup>106</sup>

Këto dy qytete përjetuan në fakt dy pushtime, të parin nga turqit, si shumë qendra të tjera mesjetare shqiptare dhe pushtimin e dytë nga sllavët në shek. XIX, duke përfshirë edhe Ulqinin. Këto dy qytete, sidomos Tivari, arqipeshkvi me shumë sufragane, morën me kalimin e kohës pamjen e një qyteti oriental,<sup>107</sup> duke humbur pra natyrën e tyre katolike-romane. Krahas kësaj Tivari në fund të shek. të XIX mori goditjen përfundimtare duke u shkatërruar nga malazezët.

### **Përfundim**

Sipas Shuflajt, *“forca armiqësore e turqve, e shkatërroi, asgjësoi dhe e shpërbëri përmbajtjen e gjallë e këtyre qyteteve, përmbajtja ajo që ishte mbartës i ekzistencës autonome qytetare, por ajo nuk shkatërroi vetëm bërthamën por çau edhe membranën dhe e dëmtoi atë rëndë.*<sup>108</sup>

Pra, po sipas Shuflajt, për këto qytete shqiptare fillon vdekja fyletike,<sup>109</sup> që do të thotë vdekje e çdo lloj organizimi apo administrimi, që ka të bëjë me këto qytete dhe origjinën e tyre. Sundimi i turk që u shtri në shekullin XVI mbi të gjitha qytetet dhe trojet shqiptare shkaktoi edhe një boshllëk shumë të madh në lidhje me materialet për historinë e brendshme të këtyre qyteteve,<sup>110</sup> sepse çdo gjë u shkatërrua ose humbi, e kemi fjalën këtu për institucione si kisha, shkolla, biblioteka manastiresh dhe kishash, kancelari, etj, etj., që posedonin materiale dokumente, statute, etj. në lidhje me jetën politike, ekonomike dhe kulturore të këtyre qyteteve. Dhe Shuflaj në fillim të shekullit të XX arrin në konkluzionin që *“Shqipëria, qenia e sotme e së cilës nëpërmjet sundimit të turqve ka*

<sup>105</sup> *Po aty*, f. 40.

<sup>106</sup> *Po aty*, f. 39, 40.

<sup>107</sup> P. Bogdani, “Tivari”, në: *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*. Vëll. III., f. 2717.

<sup>108</sup> Milan von Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*. Vorgelegt in der Sitzung am 24. April 1918. Kommissions-Verleger der Akademie der Wissenschaften in Wien. Wien/Leipzig: Holder-Pichler-Tempsky A.-G. 1924, f. 5 (Cituar si: M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens*, f.).

<sup>109</sup> *Po aty*, f. 6.

<sup>110</sup> *Po aty*.

*rënë thellë nën nivelin e jetës së saj mesjetare shumë të zhvilluar*<sup>111</sup>. Ndryshimet që solli pushtimi osman ishin rrënjësore.

Siç e pamë edhe më sipër, qytetet ose u shkatërruan plotësisht, ose u zvogëluan dhe me kalimin e kohës si rrjedhojë sot kanë mbetur vetëm disa mbeturina nga ndërtesat e dikurshme mesjetare\*, nga të cilat nuk mund të nxjerrim pothuajse asnjë të dhënë nga arkitektura e këtyre qyteteve. Po ashtu nuk mund të dimë shumë, se cilat ishin format e artit dhe të kulturës në këto treva (duke përfshirë këtu të gjitha aspektet si muzikë, skulpturë, piktura murale kishash, forma të letërsisë, etj. etj.)

Në fushën e ligjit dhe të organizimit të qyteteve vendin e statuteve të vjetra, shenjë e autonomisë së tyre (e kemi fjalën këtu për statutet e Shkodrës, të Drishtit dhe të Dejës<sup>112</sup>, këto të fundit akoma të panjohura për studiuesit shqiptarë) e zunë kanunametë e pushtuesit osman. Në Shkodër, më saktë në vilajetin e Cërnojeviqve në veri të liqenit të Shkodrës, dhe në trevat e Hotit dhe të Kelmendit, u bënë përpjekje që ligjet e para osmane (norma kanunore) të vendoseshin që në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XV, kurse kanunameja e parë e plotë

<sup>111</sup> “Albanien, dessen heutiges Wesen durch die Türkenherrschaft tief unter das Niveau seines hochentwickelten mittelalterlichen Lebens gesunken ist [...]”. Milan von Šufflay, “Die Grenzen Albaniens im Mittelalter“, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [e të tjerë]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 293. (Cituar si: M. Šufflay, “Die Grenzen Albaniens im Mittelalter“, në *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f.).

\* Kam parasysh këtu rrënojat brenda në kështjellën e *Rozafës* duke përfshirë mbetjet e Kishës së Shën Shtjefnit që u kthye më vonë në xhami e pastaj në depo municionesh që u hodh në erë nga vetëtimat në vitin 1874. *Shih për këtë*: Gopčević, *Geschichte von Montenegro und Albanien*. Gotha 1914, f. 275; Franc Baron von Nopça, *Shqipëria. Fiset e malësisë së Shqipërisë (kanuni) prej Dr. Franz Baron Nopça*, material i pabotuar, i përkthyer nga Petraq Zallari. Bibl. Komb. Austriake. Photo Nr. M 1263. 63 SER.NOV. 9392.

<sup>112</sup> Deja kishte edhe “statutin e saj”, të përbërë prej mbi 500 nyjash, “si një prej statuteve më të plotë të gjithë qyteteve të vijës bregdetare adriatike, prej Vlorës, deri në Piran e Zadar”. Ky statut ndodhet, sipas Sinanit, në Arkivin Shtetëror Kroat, dhe i përket fondit personal “Milan Shufflay”. Ne pra akoma edhe sot nuk e njohim përmbajtjen e këtij statuti. *Shih për këtë*: Shaban Sinani, “Dr. Milan Shufflay (Šufflay), Acta Albania III”, në: *Perla*, nr. 3, 2002, f. 33.

për sanxhakun e Shkodrës i përket vitit 1529.<sup>113</sup> Sipërfaqe të tëra të mbjella me vreshta dhe me ullishte u shkatërruan dhe sot nuk u shihen as gjurmët. Këtu kam parasysh librin e koncesioneve të regjistrit të kadastrës së Shkodrës 1416-1417, i cili na paraqet një tablo të detajuar të koncesioneve në qytetin e Shkodrës dhe në rrethinat e tij.<sup>114</sup>

Së fundi, po përmend këtu edhe ndryshimin e fesë në masë, që filloi që gjatë shekullit XV me konvertime dhe me shkatërrimin e institucioneve kishtare dhe vazhdoi vende- vende deri në shekullin XIX, që u shoqërua me shkatërrimin sistematik të arqipeshkvive me sufraganet e tyre, të cilat përbëheshin nga një rrjet i gjerë kishash dhe manastiresh, të mbjella dendur në Shkodrën mesjetare dhe në rrethinat e saj, duke filluar në veri nga Tivari e duke përfunduar në Lezhë.

### *S u m m a r y*

#### SOME ASPECTS OF THE OTTOMAN INVASION OF SHKODRA AND THE SURROUNDING AREAS AT THE END OF THE 15<sup>TH</sup> CENTURY

This article focuses on some aspects of the dusk of the medieval Albanian civilization, which was caused by the ottoman invasion. As a case study is taken the town of Shkodra and several other surrounding centers such as, Drishti, Deja and Lezha.

Thus, this paper will be geographically focused in the regions from the mouth of Buna river, the regions of Shirgj and Shas, Shkoder, near which were located Baleci, Drishti and the village of Ostros where the famous monastery of "The Pure of Kraja" was situated, and which used to be a catholic bishopric. Moreover, the paper will study the regions of Drin, Deje and Sarde as well as Lezhe and Shen Gjin. In this wide territory were situated several medieval towns and many villages, monasteries, churches and other religious buildings

---

<sup>113</sup> *Ligji Osman ndër Shqiptarët e Mesjetës së vonë* (gjysma e dytë e shekullit XV – fillimshekulli XVII). Përktheu nga turqishtja osmane e përgatiti edicionin tekstual kritik Dritan Egro, QSA, Tiranë: "Kristalina-KH", 2012, f. 89-96.

<sup>114</sup> "Regjistri i koncesioneve", në: *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*. Përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Instituti i Historisë) Tiranë: 1977, f. 129-203.

which are entirely non-existent nowadays, because they were totally ruined during the ottoman armies' raids. Furthermore, in this paper will be presented some important facts related to the invasion of Ulqin and Tivar, as these towns had close and direct economical, political, religious and cultural relations with the above mentioned regions and in the 16<sup>th</sup> century became part of the *sanjak* of Shkodra. All the above mentioned centers are situated near Shkodra.